



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dorezuar Punëpunë/Prodato Received/Delivered	10.08	2022	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jednica Org./Unit	It. Proct It. Proct Prof. No.	Shifra e Prirës Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIS/PIH/HC	4649/2022		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.573/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.573/2022 të datës 27.06.2022 e parashtruar nga ankuesja me adresë kundër organit të punësimit/Agjencisë Kundër Korrupsionit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 10.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër Anr.573/2022 e datës 27.06.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET në fuqi Përgjigja në ankesë e datës 31.05.2022 e Komisionit për Zhvillimin e Procedurave për Pranimin në Karrierë në Shërbimin Civil.

A r s y e t i m

Ankuesja ka aplikuar në konkursin e shpallur me numër referencës RN00008614 nga Agjencia Kundër Korrupsionit, i publikuar sipas njoftimit të datës 16.03.2022 dhe afati për aplikim nga data 06.04.2022 deri me datë 13.04.2022, në vendin e lirë të punës Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm në pozitën "Asistent Ekzekutiv". Në të cilën procedurë ankuesja ka qenë e përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit dhe pas intervistës me gojë, ankuesja është njoftuar me datë 24.05.2022 lidhur me pikët e arritura, gjithsejtë 86.8 pikë, duke u renditur e katërta në listën përfundimtare dhe duke e njoftuar për të drejtën e ankesës prej 3 ditësh.

Ankuesja ka parashtruar ankesë me datë 25.05.2022 tek Komisioni për zhvillimin e procedurave për pranim dhe karrierë në shërbimin civil, me pretendime ankimore se si pasojë e shkeljeve të kushteve të përcaktuara të konkursit e që kanë të bëjnë me detyrat dhe përgjegjësit kryesore dhe njohurit shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës vetë përzgjedhja e kandidatëve nga ana e komisionit është shkelje ligjore bazuar në kriteret për kualifikim në bazë të konkursit.

Me datë 31.05.2022 Komisioni për zhvillimin e procedurave për pranim dhe karrierë ka nxjerrë përgjigje në ankesë, duke e njoftuar se ankesa është adresuar gabimisht pasi që legjislacioni në fuqi nuk ka më komision të ankesave brenda institucioneve po ashtu edhe në Agjencinë Kundër Korrupsion. Pavarësisht adresimit të gabuar Komisioni ka shqyrtuar ankesën duke konsideruar se çdo pretendim i ngritur është plotësisht i pabazë. Komisioni ka konstatuar se vlerësimi në të gjitha fazat e procedurës është bërë konform Rregullores Nr.16/20 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës duke e renditur në listën përfundimtare me numër katër me gjithsejtë 86.8 pikë. Pretendimet e ngritura përmes ankesës i konsideron si të pabaza dhe si e tillë refuzohet.

Ankuesja [redacted] me datë 27.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3728/2022 të regjistruar me numër A.nr.573/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të komisionit në Agjencinë Kundër Korrupsionit për pozitën "Asistent Ekzekutiv"

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 08.07.2022, ankesën e ankueses e ka dërguar për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kundër Korrupsion, ndërsa me datën 18.07.2022 me numër protokollit 4160/2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia Kundër Korrupsion, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:3728/2022 të datës 27.06.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga B.B. për ankesa.kpmsheck@rks-gov.net i datës 27.06.2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve nga SIMBNJ; Përgjigje në ankesë e datës 31.05.2022; Konkursi i datës 16.03.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 08.07.2022; Përgjigje në ankesë e datës 18.07.2022; Vendim me nr. protokollit 01-1977/22 i datës 28.04.2022; Ankesë e ankueses e datës 25.05.2022; Lista e Aplikantëve nga SIMBNJ; Pyetjet për test 1/10; Lista e Aplikantëve nga SIMBNJ; E-mail nga S.J. për C.Z. i datës 25.06.2022; CV-ja e B.B.; Diplomë e B.B. me nr.3411/21 e datës 05.12.2021; Certifikatë e B.B. e datës 11.05.2017; Certifikatë e B.B. e datës 01.11.2020; Letërnjoftim i B.B.; Certifikatë e B.B. e datës 12.03.2015; Vlerësim i performancës së B.B. prej datës 01.01.2018 deri 31.12.2018; Diplomë e B.B. me nr 615 i datës 25.10.2016; Certifikatë e B.B. e datës 13.05.2016; Diplomë e B.B. me nr. 6156 i datës 18.10.2019; Vlerësim i performancës së B.B. prej datës 01.01.2018 deri 31.12.2018; Vlerësim i performancës së B.B. prej datës 01.01.2018 deri 31.12.2018; CV-ja e A.P. Diplomë e A.P. me nr. 1849 e datës 18.07.2011; Letërnjoftim i A.P.; Diplomë e A.P. me nr. 667 e datës 25.02.2015; Kontratë pune e A.P. nga Universiteti "Kadri Zeka" e datës 03.12.2021; Njoftim për kandidatin

e suksesshëm i datës 03.04.2012; Akt Emërimi i A.P. i datës 03.04.2012; Kontratë Pune për kohë të caktuar/pacaktuar e A.P. e datës 06.04.2012; Kontratë për shërbime të veçanta e A.P. e datës 18.10.2018; Letër Referencë e A.P. e muajit Nëntor 2021; CV-ja e A.O.; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Prizren për A.O. e datës 20.01.2022; Diplomë e A.O. e datës 24.07.2020; Deklaratë e A.O.; Diplomë me nr.467 e datës 14.09.2018; Certifikatë e A.O. e datës 22.07.2021; Certifikatë e A.O. nga Lëvizja Fol; Certifikatë e A.O. e datës 01.03.2020; Kontratë Pune e A.O. me nr.3623/21 e datës 25.01.2021; Letërnjoftim i A.O.; Vërtetim i A.O. i datës 11.10.2019; Pasqyra e trustit e A.O.; Letër Referencë e A.O. e datës 11.11.2020; Letër Referencë e A.O. e datës 28.09.2020; Certifikatë e A.O. e datës 14.05.2020; Aplikacioni i Y.B. i datës 15.04.2022; Certifikatë e Y.B. e muajit shtator 2018; Certifikatë e Y.B. e muajit shtator 2020; Certifikatë e Y.B. e datës 13.11.2020; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Prishtinë e Y.B.; Diplomë me nr.11983 e datës 03.09.2021; Letërnjoftimi i Y.B.; Marrëveshje për angazhim në masën aktive të tregut të punës praktike në punë e Y.B. e datës 29.03.2019; Vërtetim i Y.B. i muajit Janar 2017; Vërtetim i Y.B. i muajit Janar 2021; Vërtetim i Y.B. i muajit Gusht 2021; E-mail nga S.J. për C.Z. i datës 25.07.2022; E-mail nga S.J. për C.Z. i datës 26.07.2022; E-mail nga S.J. për B.B. i datës 24.05.2022; E-mail nga S.J. për B.D. i datës 26.07.2022; E-mail nga S.J. për A.K. i datës 27.07.2022; E-mail nga B.D. i datës 26.07.2022; E-mail nga S.J. për C.Z. i datës 27.07.2022; E-mail nga M.GJ. për S.J. i datës 27.07.2022; E-mail nga M.B. për M.GJ. i datës 27.07.2022; E-mail nga A.K. për M.GJ. i datës 27.07.2022; E-mail nga S.J. për A.K. i datës 27.07.2022; E-mail nga S.J. për A.K. i datës 27.07.2022; E-mail nga B.D. i datës 26.07.2022; E-mail nga S.J. për C.Z. i datës 01.08.2022; Aplikacioni i B.B. i datës 08.04.2022; Aplikacioni i A.O. i datës 15.04.2022; Aplikacioni i A.P. i datës 12.04.2022; E-mail nga S.J. për C.Z. i datës 04.08.2022; E-mail nga S.J. për C.Z. i datës 05.08.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar ankesa ankueses *është e pa bazuar,*
sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vendimit të Komisionit nga Agjencia Kundër Korrupsion të datës 31.05.2022 të Komisionit për pranim për pozitën "Asistent Ekzekutiv", të Agjencisë Kundër Korrupsionit, me pretendimet ankimore se si pasojë e shkeljeve të kushteve të përcaktuara të konkursit e që kanë të bëjnë me detyrat dhe përgjegjësitë kryesore si dhe njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin dhe pozitën e punës vetë përzgjedhja e kandidatëve nga ana e komisionit është shkelje ligjore bazuar në kriteret për kualifikim në bazë të konkursit si dhe komisioni ka injoruar disa nga kushtet e përcaktuara dhe mbi baza diskrecionale kanë vlerësuar me pikë më të larta kandidaten e renditur në vendin e parë sipas listës përfundimtare të vlerësimit dhe është shkelë neni 6 paragrafi 1, 2, 3, 4 i Ligjit për Zyrtarë Publik 06/L-114. Po ashtu ankuesja iu është Referuar Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht neni 43, 50 dhe 52.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, sipas shkresave të lëndës, ka konstatuar se Agjencia Kundër Korrupsion, sipas njoftimit të datës 16.03.2022 ka publikuar konkursin për grupin "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" për pozitën "Asistent Ekzekutiv", me numër reference RN00008614 për afatin për aplikim nga data 06.04.2022 deri me datë 13.04.2022, e ka shpallur duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Sipas konkursit me numër reference RN00008614, dhe njoftimit të datës 16.03.2022 i shpallur për aplikim nga data 06.04.2022 për grupin "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" për pozitën "Asistent Ekzekutiv", në Agjencinë Kundër Korrupsion, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.*
- *Kualifikime të Posaçme formale:*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar pesëdhjetë e tre (53) kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë janë përzgjedhur tridhjetë e tre (33) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja e cila e ka kaluar fazën e verifikimit dhe ka marrë pjesë në testin me shkrim, pasi që me datë 12.05.2022 është njoftuar se ka arritur gjithsejtë pesëdhjetë e nëntë (59) pikë dhe është ftuar për intervistë me gojë, pas mbajtjes së intervistës me gojë të datës 23.05.2022 dhe vlerësimit të jetëshkrimit, ankuesja është vlerësuar me gjithsejtë 86.8 pikë dhe është renditur e katërta në listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve.

Sipas Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe rrjedhimisht duke u bazuar në Shtojcën 2 të kësaj Rregullore, për pozitën e punës "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm", e renditur në numrin rendor 58 është përcaktuar që për këtë grup tek fusha e kërkuar e arsimit kërkohet Arsim i lartë i paspecifikuar, bazuar në këtë ankuesja në bazë dëshmime të përgatitjes profesionale plotëson kushtet formale të konkursit po ashtu edhe kandidatja e renditur e para plotëson kushtet formale të konkursit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se Komisioni i Pranimit ka bërë vlerësimin e ankueses dhe kandidatëve të tjerë sipas procedurave sepse vlerësimi i kandidatëve përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit /CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë, siç parashihet me nenin 16 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa nga të gjitha vlerësimet e ndërlydhura me nenin 21, 22, 23 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me nenin 24 të kësaj rregulloreje, përcaktohet se: "Shuma e pikëve të përfituara nga se cili kandidat në se cilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit ". Bazuar në këtë publikimi i renditjes përfundimtare

të kandidatëve është bërë në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: ***"2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues"***, mirëpo meqë në këtë konkurs është kërkuar vetëm një vend pune, atëherë kandidati i renditur me më së shumti pikë që në bazë të listës së renditjes përfundimtare të kandidatëve është _____ që ka marr gjithsejtë 98.8 pikë, emërohet në këtë pozitë sipas nenit 26 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: ***"Kandidati fitues, sipas renditjes, duke filluar nga ai me më shumë pikë, njoftohet nga njësia përgjegjëse për pozitën e lira dhe ka të drejtën të përzgjedhë çdo pozitë të lirë të Grupit dhe të emërohet në të, për të cilin është zhvilluar procedura e pranimit, si dhe në çdo pozitë tjetër të lirë të njëjtit Grup, që krijohet e lirë deri në një (1) vit nga shpallja publike e listës të kandidatëve fitues"***.

Në bazë të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankueses, konstaton se procedura për grupin *'Specialist i Administrimit të Përgjithshëm'* për pozitën *"Asistent Ekzekutiv"*, është zhvilluar në pajtim me nenin 6, nenin 34 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Zyrtarë Publik 06/L-114 ku përcaktohet se: ***"1.Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, pranimi në Shërbimin Civil bëhet në kategorinë profesionale në grupin e administrimit të përgjithshëm dhe në secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 2. Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë"***, dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zhvillimin e Procedurave për Pranimin në Karrierë në Shërbimin Civil në Agjencinë Kundër Korrupsion, me rastin e nxjerrjes së përgjigjes në ankesë të datës 31.05.2022, ka vepruar në pajtim me nenin 25 paragrafin 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, andaj edhe pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara. Po ashtu është i pabazuar pretendimi i ankueses e cila i është referuar se ka pasur shkelje të nenit 43, 50 dhe 52 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse me nenin 85 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës, kështu që Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nga data 09.07.2020 nuk është i zbatuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.573/2022.

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses [REDACTED]
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë Kundër Korrupsion;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Kundër Korrupsion dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;